

RAPORT

NGA MONITORIMI I ZBATIMIT TË LIGJIT PËR MBROJTJE TË DENONCUESVE, LIGJIT PËR QASJE TË LIRË NË TË DHËNAT ME KARAKTER PUBLIK DHE LIGJIT PËR VEPRIM ME PARASHTRESA DHE PROPOZIME TË 25 INSTITUCIONEVE PUBLIKE NË MAQEDONINË E VERIUT

RAPORT

nga monitorimi i zbatimit të Ligjit për mbrojtje të denoncuesve, Ligjit për qasje të lirë në të dhënat me karakter publik dhe Ligjit për veprim me parashtrës dhe propozime të 25 Institucioneve publike në Maqedoninë e Veriut

RAPORT nga monitorimi i zbatimit të Ligjit për mbrojtje të denoncuesve, Ligjit për qasje të lirë në të dhënat me karakter publik dhe Ligjit për veprim me parashtrësia dhe propozime të 25 institucioneve publike në Maqedoninë e Veriut



Instituti për hulumtime strategjike dhe edukim - IHSE

Për botuesin: Dr. Misho Dokmanoviq

Autorë: Dr. Misho Dokmanoviq, Dr. Darko Spasevski, Dr. Mlladen Karaxhoski, Marko Mitevski, Dejan Ristov, Aleksandra Noveska

Lektorimi: Mr. Liljana Jovanovska

Bototn: Stobi DOOEL



Ky projekt pjesërisht është mbështetur nga Ambasada e SHBA-së. Pikëpamjet, gjetjet dhe përfundimet ose rekomandimet e bëra këtu janë të zbatuesit, autorit(ëve) dhe nuk i pasqyrojnë ato të qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

Për projektin

Projektin "Inkurajimi i aktivizmit qytetar për monitorimin dhe raportimin e aktiviteteve të paligjshme të vetëqeverisjes lokale" e zbaton Instituti për hulumtime strategjike dhe edukim - IHSE nga Shkupi në periudhën shtator 2019 - shtator 2020. Projekti është përkrahur pjesërisht nga Ambasada e SHBA-së në Shkup.

Qëllimi i projektit është të stimulojë interesin e qytetarëve për zbatimin e disa ligjeve kryesore për ushtrimin e të drejtave të tyre në nivel lokal.

Në kuadër të projektit, IHSE ka përgatitur këtë Raport mbi monitorimin e zbatimit të Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve, Ligjit për qasje të lirë në të dhënat me karakter publik dhe Ligjit për veprim me parashtresa dhe propozime) në një total prej 25 institucionesh në pesë komuna të zgjedhura (Shkup, Manastir, Strugë, Tetovë dhe Shtip). Monitorimi u krye në bazë të 52 treguesve.

Përmes aktiviteteve të këtij projekti, përfshirë edhe përgatitjen e këtij studimi, dëshirojmë të inkurajojmë interesin e qytetarëve për të ushtruar të drejtat e tyre në nivel lokal, veçanërisht në funksion të parandalimit të veprimeve të paligjshme të autoriteteve shtetërore.

Përmbajtja

Hyrje.....	7
Raport nga Monitorimi i transparencës dhe llogaridhënies në Rajonin plano të Shkupit.....	10
Raport nga Monitorimi i transparencës dhe llogaridhënies në Rajonin planor të Pellagonisë.....	17
Raport nga Monitorimi i transparencës dhe llogaridhënies në Rajonin planor Lindor.....	25
Raport nga Monitorimi i transparencës dhe llogaridhënies në Rajonin planor Jugperëndimorë.....	33
Raport nga Monitorimi i transparencës dhe llogaridhënies në Rajonin planor të Pollogut.....	41
Përfundime dhe rekomandime.....	47
Shtojca 1: Pasqyrë e treguesve kryesorë.....	51

Hyrje

- Në kuadër të projektit "Inkurajimi i aktivizmit qytetar për monitorim dhe raportim të aktiviteteve të paligjshme të vetëqeverisjes lokale" është zbatuar një monitorim mbi punën e 25 institucioneve sa i përket zbatimit të Ligjit për mbrojtje të denoncuesve¹, Ligjit për qasje të lirë në të dhëna me karakter publik² dhe Ligjit për veprim me parashtrësia dhe propozime³ për periudhën nga viti 2016 deri më 2018. Në pajtim me qëllimet e projektit dhe zbatimin e projektit monitorimi u zbatua te pesë institucione të ndryshme të qyteteve në vijim: Shkup, Tetovë, Strugë, Shtip dhe Manastir). Më konkretisht, monitorimi ka përfshirë subjektet në vijim: Qytetin i Shkupit,
 - Gjykatën themelore penale Shkup,
 - ShMQSh Gjimnazin "Orce Nikollov" - Shkup,
 - IPSh Spitalin e përgjithshëm i qytetit "8 Shtatori" - Shkup
 - IP Qendrën ndër-komunale për punë sociale - Shkup
 - Komunën e Manastirit,
 - Gjykatën themelore - Manastir,
 - Gjimnazin "Josip Broz Tito" - Manastir,
 - Spitalin klinik "Dr. Trifun Panovski" - Manastir,
 - Institucionin publik Qendra ndër-komunale për punë sociale - Manastir
 - Komunën e Strugës,
 - Gjykatën themelore - Strugë,
 - Gjimnazin "Dr. Ibrahim Temo" - Strugë,
 - Spitalin i përgjithshëm - Strugë,
 - Institucionin publik Qendra ndër-komunale për punë sociale - Strugë,

¹ "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 196/2015 dhe 35/2018..

² "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 101/2019.

³ "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 82/2008, 13/2013, 156/2015 dhe 193/2015

- Komunën e Shtipit,
- Gjykatën themelore në Shtip,
- Qendrën për punë ndër-komunale Shtip,
- Spitalin klinik në Shtip
- ShMK "Jane Sandanski", Shtip
- Komunën e Tetovës,
- Gjimnazin e dytë "7 Marsi" - Tetovë,
- Gjykatën themelore - Tetovë,
- Spitalin klinik - Tetovë, dhe
- Institucionin publik Qendra ndër-komunale për punë sociale - Tetovë.

Të dhënat u siguruan përmes kërkesave për qasje të lirë në të dhënat me karakter publik. Nga 25 subjekte, përgjigje është marrë nga 24 subjekte, ndërsa vetëm një subjekt nuk ka dhënë asnjë përgjigje (Komuna e Tetovës), për të cilën është parashtruar ankesë pranë Agjencisë për mbrojtje të së drejtës për qasje të lirë në të dhëna me karakter publik. Treguesit që janë pjesë përbërëse të Kërkesave për qasje të lirë në të dhëna me karakter publik, janë përgatitur në pajtim me metodologjinë e shpjeguar në "Open Government: beyond static measures A paper produced by Involve for the OECD" (2009) e harmonizuar me specifikat e Maqedonisë së Veriut si dhe me mekanizmat dhe mjetet e përfshira në Ligjin për mbrojtje të denoncuesve, Ligjit për qasje të lirë në të dhëna me karakter publik dhe Ligjit për veprim me parashtrës dhe propozime. Në metodologji u identifikuan gjithsej 52 tregues. Disa prej institucioneve që kanë dorëzuar shkresa në lidhje me kërkesat për qasje të lirë në të dhëna me karakter publik, nuk kanë dorëzuar përgjigje të plotë për të gjithë treguesit. Prandaj, përveç prezantimit të treguesve, ky raport i monitorimit përmban gjithashtu një pjesë përshkruese për secilin mikro rajon veçmas, në të cilin janë analizuar të dhënat, si dhe janë dhënë konkluzione të veçanta për mikro rajonin. Në mënyrë plotësuese, në fund të Raportit, jepen gjetje dhe rekomandime të përbashkëta.

Raportet u përgatitën nga hulumtues vendas, të cilët u përzgjedhën në një konkurs publik dhe u trajnuan nga IHSE për zbatim të kësaj metodologjie.

Ky raport duhet të shihet dhe lexohet së bashku me "Studimin themelor për zbatim të Ligjit për mbrojtje të denoncuesve, Ligjit për qasje të lirë në të

dhëna me karakter publik dhe Ligjit për veprim me parshtrësia dhe propozime në nivel lokal në Republikën e Maqedonisë së Veriut", publikim i botuar në kuadër të këtij projekti, përmes të cilit është kryer analizë e këtyre ligjeve. Qëllimi i këtyre dy publikimeve është që përmes plotësimit të tyre të ndërsjellë, të realizohet analizë e dispozitave ligjore, dobësive dhe paqartësive të tyre dhe të vlerësojnë funksionimin dhe zbatimin e këtyre ligjeve në praktikë përmes analizës së punës së 25 institucioneve në 5 qytete të ndryshme.

Përmes përzgjedhjes së institucioneve, qëllimi ishte të merren parasysh ato institucione, shërbimet e të cilave përdoren çdo ditë nga qytetarët, përkatësisht shëndetësia, arsimi, mbrojtja sociale, gjyqësori dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale. Gjithashtu u vendos që të zgjedhen pesë qytete të ndryshme, në mënyrë që analiza të merret në konsideratë specifikat gjeografike dhe specifikat e tjera lokale.

Treguesit kryesorë të hulumtimit janë paraqitur në Shtojcën 1 të këtij raporti, dhe të gjitha grupet e të dhënave mund t'i shkarkoni nga faqja e internetit - www.isie.org.mk.

Raport nga Monitorimi i transparencës dhe llogaridhënies në Rajonin planor të Shkupit

Rajoni planor i Shkupit përfshin 578.144 banorë të organizuar në 18 njësi të vetëqeverisjes lokale: Qyteti i Shkupit si njësi më vete e vetëqeverisjes lokale, komunat që janë pjesë e qytetit të Shkupit: Aerodrom, Butel, Gazi Babë, Gjorçe Petrov, Karposh, Kisella Vodë, Saraj, Qendër, Çair dhe Shuto Orizare si dhe komunat e Haraçinës, Zelenikovës, Ilindenit, Petrovecit, Sopishtes, Studeniçanit dhe Çuçer Sandevës.

Lënda e monitorimit të transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve në Rajonin planor të Shkupit ishin institucionet e mëposhtme:

- Qyteti i Shkupit,
- Gjykata themelore penale Shkup,
- ShMQSh "Orce Nikollov" - Shkup,
- IPSh Spitali i përgjithshëm i qytetit "8 Shtatori" - Shkup dhe
- IP Qendra ndër-komunale për punë sociale - Shkup

Monitorimi është realizuar në bazë të të dhënave të marra nga institucionet si përgjigje ndaj kërkesave të paraqitura për qasje në të dhëna me karakter publik. Kërkesat përmbajnë gjithsej 52 pyetje, edhe atë: 19 pyetje në lidhje me Ligjin për mbrojtje të denoncuesve, 18 pyetje me Ligjin për qasje të lirë në të dhëna me karakter publik dhe 15 pyetje me Ligjin për veprim me parashtrësia dhe propozime.

Veprim në pajtim me Ligjin për mbrojtje të denoncuesve

Për veprim në pajtim me Ligjin për mbrojtje të denoncuesve, janë dorëzuar një pjesë e vogël e të dhënave të kërkuara nga institucionet që ishin lëndë e monitorimit. Qyteti i Shkupit u përgjigj se nuk kishte informacione relevante në lidhje me vlerësimin e kapaciteteve për të vepruar në përputhje me

këtë ligj, ndërsa Gjykata themelore penale - Shkup u përgjigj vetëm në dy pyetje. Spitali i përgjithshëm i qytetit "8 Shtatori" - Shkup dhe IP Qendra ndër-komunale për punë sociale - Shkup u përgjigjën, por për shkak se nuk kanë caktuar person të autorizuar për praninë të denoncimeve nga denoncuesit, shumica e pyetjeve në lidhje me këto institucione janë të pa zbatueshme.

Sipas të dhënave të marra, dy nga pesë institucionet e monitoruara kanë përcaktuar person të autorizuar për praninë të denoncimeve nga denoncuesit, edhe atë Gjykata themelore penale - Shkup dhe ShMQSh "Orce Nikollov" - Shkup. Personi i autorizuar për praninë e denoncimeve nga denoncuesit në ShMQSh "Orce Nikollov" - Shkup, institucioni i vetëm që ka paraqitur informacione më të hollësishme për personin e autorizuar, është një person me arsim të lartë, i cili punon si sekretar dhe ka përvojë pune formale prej një viti para se të emërohet si person i autorizuar për veprim në pajtim me këtë ligj. Personi ka një hapësirë të përshtatshme për praninë e palëve, i është besuar një kompjuter special me emër përdoruesi dhe fjalëkalim unik të krijuar nga personi i autorizuar dhe i njohur vetëm për të, me lidhje interneti dhe kuti të posaçme për postë elektronike me emër përdoruesi dhe fjalëkalim unik të krijuar nga personi i autorizuar dhe i njohur vetëm për të si dhe një linjë telefonike të veçantë. Personi i autorizuar nuk ka ndjekur trajnime shtesë deri më tani, për angazhimin si person i autorizuar për praninë të denoncimeve ose ankesave nga denoncuesit, ai nuk merr kompensim shtesë përveç pagës dhe në faqen e internetit të institucionit personi nuk është i listuar si person i autorizuar për praninë të njoftimeve nga denoncuesit edhe pse të dhënat e tij janë publikuar në faqen e internetit.

Sa i përket numrit të ankesave të pranuar për denoncim të brendshëm në periudhën e monitoruar nga 2016 deri në 2018, IP Qendra ndër-komunale për punë sociale - Shkup nuk ka pranuar asnjë, në ShMQSh "Orce Nikollov" - Shkup nuk ka të dhëna, ndërsa tre institucionet tjera të monitoruara nuk iu përgjigjën kësaj pyetjeje të kërkesës.

Gjykata themelore penale - Shkup, ShMQSh "Orce Nikollov" - Shkup dhe IP Qendra ndër-komunale për punë sociale - Shkup nuk kanë përshkruar akte që rregullojnë procedurat e brendshme për praninë të denoncimeve nga

denoncuesit, ndarjen dhe përpunimin e të dhënave të denocimit dhe marrjen e masave për siguri të mbrojtjes së të dhënave personale dhe të tjera që kanë të bëjnë me denoncuesit dhe denoncimet denoncuesve, ndërsa dy institucionet e tjera nuk iu përgjigjën kësaj pyetjeje.

Gjykata themelore penale - Shkup nuk ka përgatitur raport gjysmë-vjetor për denoncime të pranuar nga denoncuesit drejtuar Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit me arsyetim se që nga gushti 2018 nuk kanë marrë asnjë denoncim të vetëm, ndërsa ShMQSh "Orce Nikollov" - Shkup nuk ka të dhëna të tilla. Tre institucionet e tjera nuk iu përgjigjën fare këtyre pyetjeve.

Në lidhje me të dhënat nëse institucionet e monitoruara janë mbikëqyrur nga Ministria e drejtësisë në pajtim me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve dhe nëse është shqiptuar gjobë, ShMQSh "Orce Nikollov" - Shkup, si institucion i vetëm që iu përgjigj këtyre pyetjeve, u përgjigj se kjo nuk ka rastisur.

Pyetjes nëse institucionet kanë organizuar trajnime për punonjësit e tyre apo për persona të tjerë me qëllim njohjen e tyre me të drejtat e tyre nga Ligji për mbrojtjen e denoncuesve, poashtu u përgjigjën vetëm nga ShMQSh "Orce Nikollov" - Shkup, të cilët deri më tani nuk kanë realizuar trajnime të tilla.

Veprim në pajtim me Ligjin për qasje të lirë në të dhëna me karakter publik

Të gjithë pesë institucionet e monitoruara kanë përcaktuar persona zyrtarë që ndërmjetësojnë me të dhëna me karakter publik. Numri i personave zyrtarë në këto institucione varion nga një deri në tre dhe të gjithë kanë arsim të lartë. Personat zyrtarë nuk marrin kompensim shtesë përveç pagës dhe kanë ndjekur një deri në tre trajnime.

Në Qytetin e Shkupit, personi zyrtar për ndërmjetësim me të dhëna me karakter publik mban pozitën e Këshilltarit për dhënie të informacioneve, në IP Qendra ndër-komunale për punë sociale - Shkup në pozitën e bashkëpunëtorit të ri për bashkëpunim me qytetarë, institucione, organe të administratës shtetërore, në ShMQSh "Orce Nikollov" - Shkup persona zyrtarë janë sekretari,

pedagogu dhe psikologu, në ShMQSh "Orce Nikollov" - Shkup ata janë mjekë, ndërsa Gjykata themelore penale - Shkup nuk iu përgjigj pyetjeve që më hollësisht i referohen personit zyrtar. Të dhënat për personat zyrtarë të institucioneve që janë përgjigjur publikohen në faqet e tyre të internetit.

Qyteti i Shkupit është institucioni i vetëm që ka një hapësirë të veçantë në të cilën kërkuesi i të dhënave me karakter publik do të jetë në gjendje të ushtrrojë të drejtën e tij të qasjes.

Numër më të madh të kërkesave për qasje të lirë në informacione me karakter publik në periudhën 2016-2018 nga institucionet e monitoruara ka marrë Qyteti i Shkupit - 259, i ndjekur nga Institucioni publik Qendra ndër-komunale për punë sociale - Shkup me 103 kërkesa, IPSh Spitali i qytetit "8- Shtatori"- Shkup ka marrë 9 kërkesa, ShMQSh "Orce Nikollov" - Shkup 4 (nuk ka evidencë për vitin 2016 dhe 2017), ndërsa Gjykata themelore penale - Shkup nuk iu përgjigj pyetjeve në lidhje me kërkesat për qasje në të dhëna.

Të gjitha institucionet iu përgjigjën të gjitha kërkesave në kompetencë të tyre, ndërsa kërkesa që iu përcollën mbajtësit të informacionit përkatës në periudhën e monitoruar kishin Qyteti i Shkupit - gjithsej 7 dhe IP Qendra ndër-komunale për punë sociale - Shkup - një. Qyteti i Shkupit është institucioni i vetëm kundër të cilit në periudhën e monitorimit janë parashtruar ankesa pranë Komisionit për mbrojtje të të drejtës për qasje të lirë në informacione me karakter publik për shkak të heshtjes ose përgjigjes jo në kohën e duhur gjithsej 12 ankesa, ndërsa kundër IP Qendra ndër-komunale për punë sociale - Shkup gjithsej 3 ankesa kundër vendimeve të përgatitura. Nuk ka asnjë ankesë të tërhequr nga parashtruesit.

Qyteti i Shkupit është institucioni i vetëm nga ato që u përgjigjën cili ka arkëtuar kosto nga parashtruesit për veprim ndaj kërkesave për qasje në të dhëna me karakter publik, gjithsej 2.800 denarë në periudhën nga 2016 deri në 2018.

Asnjë nga institucionet që janë përgjigjur nuk kanë përshkruar akte të brendshme për veprim dhe procedurë për t'iu përgjigjur kërkesave për qasje të lirë në të dhëna me karakter publik, nuk ka shqiptuar asnjë sanksion disiplinor për

personat zyrtarë, as nuk janë gjobitur në pajtim me Ligjin për qasje të lirë në të dhëna me karakter publik.

Verpim në pajtim me Ligjin për veprim me parashtresa dhe propozime

Të gjitha institucionet e monitoruara përveç ShMQSh "Orce Nikollov" - Shkup kanë përcaktuar të paktën një person i cili vepron me parashtresa dhe propozime. Personat e përcaktuar kanë arsim të lartë dhe punojnë në postet Këshilltar për dhënie të të dhënave në Qytetin e Shkupit, Bashkëpunëtor i ri për bashkëpunim me qytetarë, institucione, organe të administratës shtetërore në IP Qendra ndër-komunale për punë sociale - Shkup, dy juristë në IPSH Spitali i qytetit "8- Shtatori" - Shkup ndërsa Gjykata themelore penale - Shkup nuk ka paraqitur të dhëna më të hollësishme. Personat e përmendur nuk marrin kompensim shtesë përveç pagës dhe nuk kanë ndjekur asnjë trajnim në fushën përkatëse. Qyteti i Shkupit dhe IP Qendra ndër-komunale për punë sociale - Shkup kanë publikuar të dhënat e personave të përcaktuar në faqet e tyre të internetit për dallim nga IPSH Spitali i qytetit "8 Shtatori" - Shkup. Asnjë nga institucionet që kanë paraqitur të dhëna nuk ka përshtuar akte të brendshme për veprim me parashtresa dhe propozime.

Sipas përgjigjeve të pranuar, numër më të madh të parashtresave ose propozimeve në periudhën nga 2016 deri në 2018 ka pranuar IP Qendra ndër-komunale për punë sociale - Shkup, edhe atë 217 me një vërejtje se nuk kanë të dhëna konkrete për vitin 2016. Pesë parashtresa ose propozime ka pranuar IPSH Spitali i qytetit "8 Shtatori" - Shkup, Qyteti i Shkupit dy, ndërsa ShMQSh "Orce Nikollov" - Shkup asnjë. Gjykata themelore penale - Shkup nuk ka dorëzuar të dhëna për numrin e parashtresave ose propozimeve të pranuar. Të gjitha institucionet që kanë pranuar parashtresa ose propozime mbajnë evidencë për to dhe në periudhën e monitoruar janë përgjigjur ndaj të gjithave pa arkëtuar tarifa për veprim.

Qyteti i Shkupit, ShMQSh "Orce Nikollov" - Shkup dhe IPSH Spitali i qytetit "8 Shtatori" - Shkup veprojnë me parashtresa dhe propozime që janë paraqitur nga persona anonim, ndërsa IP Qendra ndër-komunale për punë

sociale - Shkup këtë e bën vetëm për çështjet me interes publik të përcaktuara me ligj.

Asnjë nga institucionet e monitoruara nuk është gjobitur në përputhje me Ligjin për veprim me parashtresa dhe propozime.

Përfundime

- Ekziston një nivel i ulët i transparencës tek institucionet që iu nënshtruan monitorimit. Në 30% të pyetjeve të përfshira në kërkesat për qasje në të dhëna me karakter publik nuk u është marrë asnjë përgjigje. Nivel më të lartë të transparencës tregoi ShMQSh "Orce Nikollov" - Shkup e cila iu përgjigj të gjitha pyetjeve nga kërkesa, ndërsa nivel më të ulët të transparencës tregoi Gjykata themelore penale - Shkup e cila nuk u përgjigj në 85% të pyetjeve.
- Sipas të dhënave të marra, vetëm Gjykata themelore penale - Shkup ka përcaktuar persona të autorizuar që veprojnë në bazë të Ligjit për mbrojtje të denoncuesve, Ligjit për qasje të lirë në të dhëna me karakter publik dhe Ligjit për veprim me parashtresa dhe propozime.
- Personat e autorizuar për veprim në bazë të Ligjit për mbrojtje të denoncuesve, Ligjit për qasje të lirë në të dhëna me karakter publik dhe Ligjit për veprim me parashtresa dhe propozime kanë arsim të lartë, por trajnime të pamjaftueshme të fushës konkrete dhe për ta nuk është përcaktuar kompensim shtesë për autorizimet.
- Asnjë nga institucionet e monitoruara nuk ka miratuar akte të brendshme që rregullojnë procedurat në pajtim me Ligjin për mbrojtje të denoncuesve, Ligjin për qasje të lirë në të dhëna me karakter publik dhe Ligjin për veprim me parashtresa dhe propozime.
- Ekziston një nivel jashtëzakonisht i ulët i zbatimit të Ligjit për mbrojtje të denoncuesve. Vetëm dy nga pesë institucionet kanë një person të autorizuar për pranim të ankesave ose kallëzimeve. Në periudhën e monitoruar nga 2016 deri në 2018, tek institucionet që janë përgjigjur nuk është evidentuar asnjë raport i vetëm nga denoncuesit.

Raport nga monitorimi i transparencës dhe llogaridhënies në Rajonin planor të Pellagonisë

Rajoni planor i Pellagonisë përbëhet nga 9 komuna: Manastir, Demir Hisar, Krivogashtan, Krushevë, Mogillë, Prilep, Resnje, Novaci dhe Dolneni. Sipas të dhënave nga regjistrimi i fundit i popullsisë dhe familjeve të realizuar në 2002, në Rajonin planor të Pellagonisë jetojnë 238 136 banorë.

Lënda e kësaj analize dhe këtij raporti janë institucionet në vijim: Komuna e Manastirit, Gjykata themelore - Manastir, Gjumnazi "Josip Broz Tito" - Manastir, Spitali klinik "Dr. Trifun Panovski" - Manastir dhe Institucioni publik Qendra ndër-komunale për punë sociale - Manastir.

Verpim në pajtim me Ligjin për mbrojtje të denoncuesve

Komuna e Manastirit dhe Gjykata themelore - Manastir janë dy institucionet që kanë përcaktuar persona të autorizuar për pranim të ankesave ose kallëzimeve. Institucionet e tjera të analizuara nuk kanë emëruar persona të tillë (prandaj, do të përjashtohen nga kjo pjesë e analizës). Në pajtim me Ligjin për mbrojtje të denoncuesve, nëse nuk ka të emëruar person të autorizuar, automatikisht konsiderohet se personi për kallëzime ose ankesa është personi që drejton institucionin përkatës (drejtori, etj.).

Po ashtu, këto dy institucione kanë përshkruar akte që rregullojnë procedurat e brendshme për pranim të ankesave nga denoncuesit, ndarje dhe përpunim të të dhënave nga ankesat dhe marrje të masave për të siguruar mbrojtje të të dhënave personale dhe të tjera që lidhje me denoncuesit dhe ankesat e denoncuesve, ndërsa të gjitha institucionet e tjera të analizuara u përgjigjën se nuk kanë përshkruar akte të tilla. Personat e autorizuar për pranim të ankesave/denoncimeve nga denoncuesit në Komunë dhe Gjykatë kanë arsim të lartë (në Komunë me Fakultet juridik të mbaruar). Në Komunë, personi kishte

25 vjet përvojë pune para emërimit në këtë detyrë, ndërsa në Gjykatë 10 vjet. Në Komunën e Manastirit, pozicioni i personit të autorizuar është Udhëheqës i njësisë për menaxhim me burime njerëzore, i cili nuk ka ndjekur trajnime në lidhje me pozicionin, ndërsa në Gjykatën themelore - Manastir Gjykatës, i cili ka ndjekur një trajnim të financuar nga organizatori i trajnimit. Gjykata themelore - Manastir nuk ka fonde të posaçme për punë të destinuara për personin e autorizuar (Komuna e Manastirit nuk ka dorëzuar informacione), dhe nuk ka kompensim shtesë jashtë pagës për personat e autorizuar në të dy institucionet.

Lidhur me numrin e njoftimeve të pranuar për kallëzime/ankesa të brendshëm, në pajtim me Ligjin për mbrojtje të denoncuesve, të cilët i referohen 2016, 2017 dhe 2018, Komuna e Manastirit dhe Gjykata themelore - Manastir u përgjigjën se nuk kanë pranuar asnjë kërkesë të vetme në vitet e përmendura.

Për asnjë nga institucionet nuk është bërë kallëzim/denoncim i jashtëm i mbrojtur në pajtim me Ligjin për mbrojtje të denoncuesve në tre vitet e analizuar, dhe gjithashtu në asnjë institucion nuk është kryer procedurë për mbikëqyrje nga Ministria e drejtësisë, në pajtim me dispozitat e Ligjit. Raportet gjysmë-vjetore për denoncime të pranuar nga denoncuesit drejtuar Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, deri më tani fare nuk janë dërguar nga institucionet e analizuar. Sipas Ligjit të përmendur, asnjë institucion nuk është gjobitur, dhe gjithashtu asnjëri nga institucionet nuk ka organizuar trajnime për punonjësit e tyre ose persona të tjerë, në mënyrë që t'i njohë ata me të drejtat e tyre sipas Ligjit për mbrojtje të denoncuesve, dhe në mënyrë që të mund të raportojnë për parregullsi në pajtim me Ligjin. Të dhënat për kontaktit të personave të autorizuar për veprim në bazë të kallëzimeve/denoncimeve të denoncuesve janë shpallur publikisht në faqet e internetit të Komunës së Manastirit dhe Gjykatës themelore - Manastir.

Veprim në pajtim me Ligjin për qasje të lirë në të dhëna me karakter publik

Të gjitha institucionet kanë përcaktuar persona zyrtarë për realizimin e të drejtës së qasjes së lirë në të dhëna me karakter publik, me përjashtim të Spitalit klinik "Dr. Trifun Panovski" - Manastir. Komuna e Manastirit, Gjykata themelore -

Manastir dhe Qendra ndër-komunale për punë sociale - Manastir kanë nga një person zyrtar, ndërsa Gjimnazi "Josip Broz Tito" - Manastir ka dy persona zyrtarë. Personat zyrtarë në të gjitha institucionet kanë arsim të lartë, ndërsa Gjykata themelore në Manastir dhe Qendra ndër-komunale për punë sociale - Manastir kanë saktësuar që personi në atë pozicion duhet të jetë i diplomuar në Fakultetin juridik. Në Komunën e Manastirit, nga ana tjetër, personi në këtë pozicion ka kryer Fakultetin e filologjisë, por edhe master në marketing/menaxhim.

Asnjë nga institucionet nuk parasheh kompensim shtesë jashtë pagës për këta persona zyrtarë. Në Komunën e Manastirit, pozicioni i punës i personit zyrtar, sipas akteve për sistematizim të vendeve të punës është Këshilltar për kulturë. Në Gjykatën themelore në Manastir është bashkëpunëtor profesional, ndërsa në Gjimnazin "Josip Broz Tito" është sekretar dhe sociolog. Në Qendrën ndër-komunale për punë sociale - Manastir, në atë pozicion pune, personi është jurist në shërbimin për çështje administrative, persona ndihmës - teknikë dhe burime njerëzore. Në Komunën e Manastirit, personi i autorizuar ka vijuar tre trajnime, dy prej të cilave të financuara nga donatorët, dhe një nga Komuna e Manastirit, ndërsa në Gjykatën themelore - Manastir, personi i autorizuar ka ndjekur një trajnim, të financuar nga organizatori i trajnimit. Në institucionet e tjera, personat e autorizuar nuk kanë ndjekur asnjë trajnim. Asnjë nga institucionet e analizuar nuk ka përshtatur akte të përshtatshme të brendshme për veprim dhe procedurë për t'iu përgjigjur kërkesave për qasje të lirë në informacione me karakter publik.

Sa i përket numrit të kërkesave të pranuar për qasje të lirë në informacione me karakter publik, Komuna e Manastirit gjatë vitit 2017 ka pranuar 41 kërkesa, ndërsa në vitin 2018 47 kërkesa (nuk ka dorëzuar të dhëna për vitin 2016). Në vitin 2017, dy kërkesa u paraqitën nga kërkuesi drejtuar Komisionit për mbrojtje të së drejtës për qasje të lirë në të dhëna me karakter publik. Në vitin 2018 nuk ka pasur ankesa (nuk u dorëzuan të dhëna për vitin 2016). Në mënyrë analoge, në afatin e përcaktuar me ligj, në vitin 2017, iu përgjigjën 39 kërkesave, dhe në vitin 2018, 47 kërkesave (nuk u dorëzuan të dhëna për vitin 2016).

Gjykata themelore në Manastir gjatë vitit 2016 ka pranuar 41 kërkesa, në 2017 36 kërkesa, ndërsa në 2018 38 kërkesa. Gjatë tre viteve, asnjë kërkesë nuk

është dërguar tek ndonjë bartëstjetër i informacioneve në pajtim me Ligjin, dhe asnjë ankesë nuk është paraqitur pranë Komisionit për mbrojtje të të drejtës për qasje të lirë në informacione me karakter publik. Brenda afatit të përcaktuar me ligj, në tre vitet e përmendura, të gjitha kërkesat e pranuar kanë marrë përgjigje.

Gjimnazi "Josip Broz Tito" nga Manastiri gjatë vitit 2016 dhe 2017 nuk ka pranuar asnjë kërkesë të vetme, ndërsa në vitin 2018 ka pranuar 2 kërkesa të cilave iu përgjigj në kohën e duhur.

Spitali klinik "Dr. Trifun Panovski" - Manastir fare nuk mban shënime të tilla, ndërsa Qendra ndër-komunale për punë sociale - Manastir gjatë vitit 2016 ka pranuar 4 kërkesa, në 2017 6 kërkesa, poashtu edhe në 2018 6 kërkesa. Gjatë tre viteve, asnjë kërkesë nuk është dërguar tek ndonjë bartës tjetër i informacioneve në pajtim me Ligjin, dhe asnjë ankesë nuk është paraqitur pranë Komisionit për mbrojtje të të drejtës për qasje të lirë në të dhëna me karakter publik. Brenda afatit të përcaktuar me ligj, në tre vitet e përmendura, të gjitha kërkesat e pranuar kanë marrë përgjigje.

Asnjë institucion nuk ka arkëtuar asnjë kosto nga kërkuesit e informacioneve, ndërsa të dhënat për kontakt të personit të autorizuar për realizim të së drejtës për qasje të lirë në të dhëna me karakter publik shpallen publikisht në faqet e internetit të të gjitha institucioneve ku ekziston një person i tillë. Në asnjë institucion nuk janë shqiptuar dënime disiplinore për personat përgjegjës dhe poashtu asnjë institucion nuk është gjorbitur në pajtim me Ligjin për qasje të lirë në informacione me karakter publik. Asnjë institucion nuk ka siguruar hapësirë të veçantë për realizim të të drejtës së qasjes (Gjykata themelore në Manastir do të parashikonte për secilën kërkesë individuale, ndërsa personi i përcaktuar në Qendrën ndër-komunale për punë sociale - Manastir është i vetëm në zyrë, që në njëfarë mënyre pjesërisht plotëson këtë kriter).

Veprim në pajtim me Ligjin për veprim me parashtresa dhe propozime

Të gjitha institucionet e analizuar kanë persona të autorizuar që veprojnë me parashtresa dhe propozime. Në të gjitha institucionet, personat e autorizuar kanë përfunduar arsim të lartë, dhe me përjashtim të Gjimnazit "Josip Broz Tito" nga Manastiri (ku nuk figuron asnjë profil konkret i arsimit të lartë), në të gjitha institucionet e tjera personat e autorizuar kanë mbaruar Fakultetin juridik. Asnjë nga institucionet nuk parasheh kompensim shtesë jashtë pagës për personat e autorizuar.

Në Komunën e Manastirit, pozita e punës të zyrtarit të autorizuar, në pajtim me aktet për sistematizim të vendeve të punës është Udhëheqës i njësisë për çështje normative-juridike, ndërsa në Gjykatën themelore në Manastir është gjykatës. Në Gjimnazin "Josip Broz Tito" të Manastirit ai është sekretar, në Spitalin klinik "Dr. Trifun Panovski" - Manastir personi i autorizuar është Bashkëpunëtor i ri për çështje juridike, ndërsa në Qendrën ndër-komunale për punë sociale - Manastir, pozita e punës është jurist në shërbim për të drejtat. Asnjë nga personat e autorizuar në të katër institucionet nuk ka ndjekur trajnime përkatëse. Po ashtu, përveç në Gjimnazin "Josip Broz Tito" të Manastirit, asnjë institucion tjetër nuk ka përshkruar akte të brendshme për veprim me parashtresa dhe propozime (nga Spitali klinik "Dr. Trifun Panovski" - Manastir theksojnë se për procedura të tilla zbatohen dispozitat nga Ligji për kujdes shëndetësor).

Lidhur me parashtresat dhe propozimet e pranuar, për vitin 2016 Komuna e Manastirit ka pranuar 1603 kërkesa, për vitin 2017 - 1155, dhe për 2018 - 1593 kërkesa. Të gjitha parashtresat kanë marrë përgjigje, dhe për pasojë, kërkuesi nuk ka paraqitur ankesë dhe nuk i është drejtuar Avokatit të popullit në asnjë rast. Gjykata themelore - Manastir nuk ka pranuar asnjë kërkesë të vetme në tre vitet e përmendura, ndërsa Gjimnazi "Josip Broz Tito" - Manastir ka pranuar vetëm një kërkesë në vitin 2017, e cila është përgjigjur. Spitali klinik "Dr. Trifun Panovski" - Manastir nuk ka paraqitur përgjigje për vitin 2016, në vitin 2017 ka marrë 14 kërkesa, ndërsa në 2018 5 kërkesa. Të gjitha parashtresat u përgjigjën, dhe për pasojë, kërkuesi nuk ka paraqitur ankesë. Qendra ndër-komunale për punë sociale - Manastir në vitin 2016 ka pranuar 13 kërkesa, në

vitin 2017 - 10 kërkesa, dhe në 2019 - 9 kërkesa. Të gjitha kërkesat u përgjigjën siç duhet, por nganjëherë palët kanë parashtruar parashtresa tek Avokati i Popullit.

Sa i përket parashtresave dhe propozimeve të paraqitura nga denoncues anonim, Komuna e Manastirit iu përgjigjet njoftimeve të tilla, Gjimnazi "Josip Broz Tito" - Manastir nuk përgjigjet, Spitali klinik "Dr. Trifun Panovski" - Manastir nuk përgjigjet (përveç çështjeve me interes publik të përcaktuara me ligj), Qendra ndër-komunale për punë sociale - Manastir nuk ka pranuar fare kërkesa të tilla, ndërsa Gjykata themelore - Manastir nuk ka dhënë informacion. Të gjitha institucionet mbajnë shënime për parashtresat dhe propozimet e pranuar, dhe asnjë institucion nuk ka arkëtuar ndonjë kompensim në bazë të tarifave për veprim me propozime në lidhje me tre vitet e përmendura. Gjithashtu, asnjë nga këto institucione nuk është gjobitur në pajtim me Ligjin për veprim me parashtresa dhe propozime. (Gjykata themelore - Manastir dhe Spitali klinik "Dr. Trifun Panovski" - Manastir nuk kanë paraqitur përgjigje). Detajet e kontaktit të personave të autorizuar janë publikuar vetëm në faqen e internetit të Gjykatës themelore - Manastir dhe Spitalit klinik "Dr. Trifun Panovski" - Manastir.

Përfundime

Sipas analizës së realizuar, të dhënat e grumbulluara empirike dhe rezultatet e përmbledhura, mund të konkludohet se institucionet e analizuara në territorin e Komunës së Manastirit në përgjithësi disponojnë me kapacitete institucionale të kënaqshme për zbatimin e dispozitave përkatëse të Ligjit për mbrojtje të denoncuesve, Ligjit për qasje të lirë në informacione me karakter publik dhe Ligjit për veprim me parashtresa dhe propozime, të cilat i referohen transparencës dhe llogaridhënies.

Sa i përket zbatimit të të gjitha ligjeve, ka persona të autorizuar të veçantë për pranim dhe veprim ndaj kallëzimeve/denoncimeve për korrupsion, kërkesat për qasje të lirë në të dhëna me karakter publik, si dhe parashtresat dhe propozimet. Në të gjitha institucionet, personat janë me kualifikim të lartë dhe kompetentë, ndërsa në institucione të caktuara (Komuna e Manastirit dhe Gjykata themelore - Manastir) ata kanë përvojë pune solide. Mungesa e trajnimeve

profesionale të realizuara në lidhje me zbatimin e tre ligjeve është evidente (vetëm Komuna e Manastirit dhe Gjykata themelore - Manastir manifestojnë disa aktivitete në atë drejtim, institucionet e tjera nuk marrin pjesë fare në trajnime).

Gjendje identike është vërejtur në të gjitha institucionet në lidhje me disa parametra, gjegjësisht: asnjë institucion nuk është gjobitur për sa i përket veprimit në pajtim me ligjet (në institucionet që paraqitën informata); janë dorëzuar përgjigje nga të gjitha institucionet për pothuajse të gjitha kërkesat e pranuar (vetëm në Komunën e Manastirit në vitin 2017 janë paraqitur dy ankesa për shkak të përgjigjes jo të plotë), parashtresa dhe propozime; parashtresit nuk kanë paguar asnjë tarifë, kosto apo harxhim në asnjë institucion, por nga ana tjetër personave zyrtarë të autorizuar për këto raste nuk u është paguar asnjë kompensim shtesë jashtë pagës së rregullt; asnjë masë disiplinore nuk është shqiptuar për personat përgjegjës (në institucionet që kanë dorëzuar informacion); të gjithë personat e autorizuar zyrtarë kanë arsim të lartë; në të gjitha institucionet mbahen regjistrime të kërkesave, parashtresave dhe propozimeve të pranuar dhe asnjë institucion deri më tani nuk ka siguruar hapësirë të veçantë për ushtrimin e të drejtës së qasjes nga kërkuesi.

Ekziston një shumëllojshmëri e përgjigjeve në lidhje me aktet e përshkruara të brendshme për veprim (situatë e ndryshme në institucione në zbatimin e tre ligjeve), trajnimet e ndjekura nga personat e autorizuar, si dhe në shpalljen publike të të dhënave të tyre në faqet e internetit.

Në përgjithësi, performanca institucionale e të gjitha subjekteve të analizuar në Manastir është e ngjashme, gjegjësisht nuk ka institucion me pozicion superior ose anasjelltas me pozicion inferior në kontekstin e zbatimit të tre ligjeve. Sidoqoftë, Komunën e Manastirit do ta apostrofojmë si institucionin më aktiv dhe më të angazhuar për sa i përket aktiviteteve të realizuara administrative, por nga ana tjetër, me disa mangësi në drejtim të transparencës dhe llogaridhënies.

Raport nga monitorimi i transparencës dhe llogaridhënies në Rajonin planor Lindor

Rajoni lindor është një nga tetë rajonet statistikore në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Ky rajon ndodhet në pjesën lindore të vendit dhe kufizohet me rajonin e Vardarit, Shkupit, Verilindjes dhe Juglindjes. Vendndodhja e rajonit lindor mbulon zonën e pellgut të lumit Bregalnica, mbulon 14% të territorit të vendit dhe ka një sipërfaqe prej 3537 km².

Ky rajon përbëhet nga njëmbëdhjetë komuna, edhe atë Shtip, Berovë, Vinicë, Dellçevë, Zërnovc, Karbinci, Koçani, Makedonska Kamenicë, Pehçevë, Probishtip dhe Çeshinovë-Obleshevë, të cilat për sa i përket urbanizimit ndahen në 217 vendbanime, nga të cilat 209 karakterizohen si vendbanime rurale.

Numri i përgjithshëm i banorëve në rajon është 181,858. Dendësia e popullsisë është 51 banorë për km². Mirëpo, për shkak të procesit të përhershëm të shpopullimit, numri i fshatrave të shpërngulur është i madh, fshatra me madhësi prej 100 banorëve dhe fshatra me indeks të theksuar të lartë të plakjes. Kjo situatë çon në përqendrim të rreth 66% të popullsisë në zonat urbane. Rajoni ka gati katër herë rritje më të vogël të popullsisë në krahasim me rritjen e popullsisë së shtetit.

Kjo analizë i dedikohet matjes së transparencës dhe llogaridhënies të një pjese të institucioneve në Rajonin planor Lindor duke vepruar në pajtim me Ligjin për mbrojtje të denoncuesve, Ligjin për qasje të lirë në të dhëna me karakter publik dhe Ligjin për veprim me parashtrësia dhe propozime. Lënda e këtij hulumtimi ishin Komuna e Shtipit, Gjykata themelore në Shtip, Qendra për punë ndër-komunale Shtip, Spitali klinik në Shtip dhe ShMK "Jane Sandanski", Shtip. Në mënyrë metodologjike të dhënat për këtë hulumtim u mblodhën përmes kërkesave për qasje të lirë në të dhëna me karakter publik, si dhe paraqitje të dokumenteve shtesë, siç janë raportet gjysmë-vjetore në raport me Ligjin për denoncues dhe Rregulloren për raportim të brendshëm të mbrojtur në institucionet e sektorit publik.

Veprim në pajtim me ligjin për mbrojtje të denoncuesve

Komuna e Shtipit, Gjykata themelore në Shtip dhe Qendra ndër-komunale për punë sociale nuk kanë përcaktuar person të autorizuar për pranim të kallëzimeve/denoncimeve në bazë të Ligjit për mbrojtje të denoncuesve, ndërsa Spitali klinik në Shtip dhe ShMK "Jane Sandanski" Shtip kanë përcaktuar person që pranon kallëzime në pajtim me këtë ligj. Në shkollë, njoftimet i pranon personi udhëheqës i cili është magjistër i shekncave të stomatologjisë dhe ka përvojë pune të pandërprerë që nga viti 2003 dhe të dhënat e tij janë të publikuara në faqen e internetit, ndërsa në spital këtë e bën personi përgjegjës për pranim të kallëzimeve/denoncimeve i cili ka arsim të lartë dhe përvojë pune mbi pesë vjet dhe punon si këshilltar për çështje të përgjithshme. Të dhënat e tij nuk janë publikuar në faqen e internetit. Këta dy persona që janë emëruar të vepronë në bazë të Ligjit për mbrojtje të denoncuesve nuk kanë ndjekur asnjë trajnim.

Në ShMK "Jane Sandanski", Shtip nuk ka pajisje teknike dhe organizative dhe masa për veprim sipas Ligjit për mbrojtje të denoncuesve për pranim dhe veprim në bazë të kallëzimeve/denoncimeve për korrupsion, por kanë pajisje teknike dhe organizative, në pajtim me Ligjin për mbrojtje të të dhënave personale. Spitali klinik ka një hapësirë pune të përshtatshme për pranim të palëve dhe një kompjuter të veçantë. Për personat e angazhuar në shkollë dhe në spital nuk është paraparë kompensim shtesë i pagës.

Shkolla "Jane Sandanski" nga Shtipi nuk ka përshkruar akte që rregullojnë procedurat e brendshme për pranim të njoftimeve nga denoncuesit, në Spitalin klinik vepronë në pajtim me ligjin, ndërsa Komuna e Shtipit, Gjykata themelore në Shtip dhe Qendra ndër-komunale për punë sociale nuk janë përgjigjur nëse posedojnë akte të tilla.

Komuna, Gjykata themelore dhe Qendra ndër-komunale për punë sociale nuk kanë paraqitur përgjigje nëse dhe sa njoftime për njoftim të brendshëm, në pajtim me Ligjin për mbrojtje të denoncuesve, kanë pranuar në institucionin e tyre në 2016, 2017 dhe 2018, ndërsa shkolla dhe spitali nuk kanë pasur asnjë njoftim të vetëm.

Institucionet, me përjashtim të Spitalit klinik, për të cilin nuk është bërë asnjë kallëzim/ankesë e jashtme e mbrojtur, nuk kanë paraqitur përgjigje nëse është bërë ndonjë kallëzim/denoncim i jashtëm i mbrojtur në pajtim me nenin 5 të Ligjit për mbrojtje të denoncuesve në 2016, 2017 dhe 2018. Po ashtu, vetëm shkolla dhe spitali u përgjigjën se nuk kanë dorëzuar raporte gjysëm-vjetore në Komisionin shtetëror për parandalim të korrupsionit në pajtim me Ligjin për mbrojtje të denoncuesve. Spitali nuk ka kryer procedurë për mbikëqyrjeje nga Ministria e drejtësisë në pajtim me nenin 15-a të Ligjit për mbrojtje të denoncuesve dhe nuk ka realizuar trajnime të punonjësve për t'u njohur me të drejtat në pajtim me Ligjin për mbrojtje të denoncuesve, ndërsa institucionet e tjera nuk janë përgjigjur. Për spitalin dhe shkollën nuk është shqiptuar ndonjë gjobë në pajtim me Ligjin për mbrojtje të denoncuesve, ndërsa institucionet e tjera nuk janë prononcuar.

Veprim në pajtim me ligjin për qasje të lirë në të dhëna me karakter publik

Pesë institucionet e monitoruara në Shtip kanë përcaktuar person për realizim të së drejtës së qasjes së lirë në të dhëna me karakter publik i cili është me arsim të lartë, përveç atij në shkollë që ka arsim të mesëm. Në komunë ky person është i përcaktuar në pozitën e këshilltarit për informim; të dhënat e tij janë të publikuara në faqen e internetit; nuk ka masa disiplinore ndaj tij dhe nuk është ngritur asnjë procedurë administrativ kundër tij. Në gjykatë, personi i përcaktuar vepron si administrator i gjykatës; të dhënat e tij janë publikuar në faqen e internetit dhe nuk ka masa disiplinore ndaj tij. Ky person, në shkollë është arkëtar; të dhënat e tij nuk janë shpallur publikisht dhe nuk ka përgjigje nëse është ndërmarrë ndonjë veprim kundër tij. Në spital, personi i autorizuar punon

si këshilltar për çështje të përgjithshme; të dhënat e tij janë të publikuara në faqen e internetit; nuk ka masa disiplinore ndaj tij; në Qendrën për punë sociale personi është i punësuar si punonjës social dhe nuk kanë paraqitur përgjigje nëse është marrë ndonjë masë ndaj tij dhe nëse janë publikuar të dhëna për të. Asnjë nga këta persona nuk merr kompensim shtesë të pagës për kryerje të kësaj pune.

Personi përgjegjës për realizimin e të drejtës për qasje të lirë në të dhëna me karakter publik në komunën e Shtipit ndjek të gjitha trajnimet në të cilat është i ftuar, dhe trajnimet që ai i ndjek financohen nga financues shtetëror dhe të huaj. Personi i emëruar nga Spitali klinik ka marrë pjesë në tre trajnime të financuara nga Komisioni për qasje të lirë në informacione me karakter publik.

Vetëm në Komunën e Shtipit kanë përshkruar akte të brendshme për veprim dhe procedurë për t'iu përgjigjur kërkesave për qasje të lirë në të dhëna me karakter publik.

Në vitin 2016, vetëqeverisja lokale në Shtip pranoi 46 kërkesa në pajtim me këtë ligj, katër prej të cilave për shkak të jokompetencës iu përcollën institucioneve të tjera, në vitin 2017 kanë pranuar 33, dhe në 2018 - 49 kallëzime ose denoncime, prej të cilave asnjëra nuk është përcjellur në ndonjë institucion tjetër. Vetëqeverisja lokale iu përgjigj të gjitha ankesave brenda afatit të përcaktuar me ligj. Nuk është dhënë përgjigje nëse ndaj ndonjë ankesë është parashtruar ankesë ndërsa komuna nuk ka arkëtuar fonde për kërkesat.

Në vitin 2016, Gjykata themelore ka pranuar nëntë kërkesa, në 2017 20, dhe në 2018 - 21 kërkesa. Të gjitha u përgjigjën në kohën e duhur dhe asnjë nuk u përcoll në ndonjë institucion tjetër. Deri te ata është parashtruar një ankesë për heshtje të administratës dhe nuk janë arkëtuar kosto për veprim me kërkesat.

Në shkollën Jane Sandanski, në këto tre vite janë pranuar pesë kërkesa për të cilat kërkuesit kanë marrë përgjigje në kohën e duhur dhe asnjëra prej tyre nuk është dërguar në ndonjë institucion tjetër. Shkolla nuk ka pranuar asnjë ankesë dhe nuk ka arkëtuar nga asnjë institucion si kërkues i informacionit.

Në spital, në vitin 2016, 2017 dhe 2018, kanë pranuar gjithsej gjashtë kërkesa, dhe në katër prej tyre janë përgjigjur në kohën e duhur. U parashtruan dy ankesa për shkak të heshtjes së administratës dhe dy të tjera u parashtruan

pranë Komisionit për mbrojtje të së drejtës për qasje të lirë në të dhëna me karakter publik. Nuk kanë arkëtuar nga asnjë kërkues i informacionit në lidhje me kërkesa për qasje të lirë në të dhëna me karakter publik.

Deri te qendra ndër-komunale për punë sociale në vitin 2016 janë paraqitur tre kërkesa, dy prej të cilave janë përgjigjur pozitivisht, ndërsa një kërkesë është refuzuar, ndaj saj është parashtruar ankesë, e cila është refuzuar nga organi i shkallës së dytë. Në vitin 2017, Qendra ka pranuar dy kërkesa dhe që të dy janë refuzuar. Për njërin nga kërkesat e refuzuara nga viti 2017 është parashtruar ankesë, e cila u refuzua nga organi i shkallës së dytë. Në vitin 2018 nuk është pranuar asnjë kërkesë. Shpenzime për kërkesa dhe ankesa nuk janë arkëtuar.

Asnjë institucion nuk është gjositur sipas Ligjit për qasje të lirë në të dhëna me karakter publik. Për sa i përket pajisjeve teknike, spitali ka një hapësirë të veçantë për personin e autorizuar, gjykata përdor një zyrë regjistrimi, ndërsa në institucionet e tjera personi nuk ka hapësirë të veçantë.

Veprim në pajtim me ligjin për veprim me parashtrës dhe propozime

Komuna, shkolla dhe Qendra për punë sociale kanë përcaktuar person i cili vepron në bazë të parashtrësve dhe ankesave, Spitali ka formuar Komision, ndërsa gjykata nuk ka përcaktuar person të tillë. Në komunë, personi i përcaktuar ka të mbaruar Fakultetin juridik dhe punon si bashkëpunëtor i lartë për përgatitje të akteve; në shkollë personi është doktor i administratës publike që punon si sekretar; në spital të gjithë anëtarët e Komisionit kanë arsim të lartë dhe specializime dhe punojnë si mjekë, ndërsa në Qendrën për punë sociale ai ka arsim të lartë, në pozicionin e sociologut dhe punon si arkivist. Asnjëri prej tyre nuk merr kompensim shtesë të pagës për këtë angazhim. Personat nuk kanë ndjekur trajnime.

Komuna e Shtipit ka përshkruar akte të brendshme për veprim me propozime dhe parashtrës; spitali vepron në pajtim me protokollet mjekësore

(rëndësia e tyre është e paqartë), ndërsa institucionet e tjera nuk kanë përcaktuar akte.

Në Komunën e Shtipit dhe ShMK "Jane Sandanski" në vitin 2016, 2017 dhe 2018 nuk janë pranuar propozime dhe parashtresa. Në Gjykatën themelore në Shtip në vitin 2016, kanë mbërritur 18 parashtresa, në vitin 2017 16 dhe në 2018, 15 parashtresa. Janë përgjigjur ndaj të gjithave, ndërsa parashtresuesi nuk iu drejtua Avokatit të Popullit për asnjë prej tyre. Në Spital kanë pranuar tre parashtresa ndaj të cilave janë përgjigjur dhe asnjëra prej tyre nuk është ankimuar tek Avokati i Popullit. Në vitin 2016, tre parashtresa janë paraqitur në Qendrën për punë sociale, në vitin 2017 numri i tyre ishte pesë, dhe në 2018 - nëntë. Me përjashtim të spitalit për të cilin nuk ka rëndësi nëse parashtresat vijnë nga parashtresuesi anonim apo jo dhe kanë vepruar në kuadër të institucionit të tyre, institucionet e tjera nuk janë prononcuar për këtë çështje.

Komuna dhe gjykata nuk kanë dhënë përgjigje në pyetjen nëse mbahet evidencë për parashtresat dhe propozimet e pranuar, ndërsa institucionet e tjera thonë se mbajnë evidencë të tillë. Të gjitha institucionet, me përjashtim të komunës së Shtipit e cila nuk ka paraqitur përgjigje, nuk kanë paguar tarifa për veprim me propozime dhe parashtresa. Komuna e Shtipit dhe Qendra për punë sociale nuk kanë paraqitur përgjigje, ndërsa institucionet e tjera nuk i kanë publikuar detajet e kontaktit të personit të autorizuar në institucion në faqet e tyre të internetit.

Përfundime

Lidhur me veprimet e institucioneve në pajtim me Ligjin për mbrojtje të denoncuesve, Komuna e Shtipit, Gjykata themelore Shtip dhe Qendra ndër-komunale për punë sociale nuk kanë përcaktuar person për pranim dhe veprim me njoftimet për korrupsion, ndërsa ShMK Jane Sandanski dhe Spitali klinik kanë përcaktuar person të tillë. Prandaj, pyetjet e tjera për tre institucionet e para mbeten pa përgjigje, ndërsa në shkollë dhe spital mund të shihet se personat e përcaktuar nuk kanë ndjekur trajnime që të dijnë si të veprojnë, kanë mjete elementare teknike për punë dhe deri më tani nuk kanë pranuar asnjë kërkesë.

Veprimet e institucioneve në pajtim me Ligjin për qasje të lirë në të dhëna me karakter publik janë krejtësisht të ndryshme. Të gjitha institucionet kanë përcaktuar persona të cilët janë të ngarkuar si mbajtës të informacionit të mundësojnë qasje në të dhëna me karakter publik që i posedojnë. Institucionet në përgjithësi janë përgjigjur në një sërë pyetjesh në lidhje me Ligjin për qasje të lirë në të dhëna me karakter publik. Në vitet e kaluara 2016, 2017 dhe 2018, deri tek të gjitha institucionet janë parashtruar kërkesa të cilave ata iu përgjigjën, ndërsa ndaj disa prej tyre kanë marrë ankesa nga kërkuessit. Nuk kanë arkëtuar për këtë shërbim dhe asnjë institucion nuk është gjobitur në pajtim me Ligjin për qasje të lirë në të dhëna me karakter publik.

Institucionet e monitoruara iu përgjigjën pjesërisht pyetjeve në lidhje me veprimin me propozime dhe parashtrësia. Të gjitha institucionet, me përjashtim të Gjykatës themelore në Shtip, kanë emëruar person i cili do të veprojë me propozime dhe procedura në pajtim me ligjin përkatës. Në Gjykatë, në Spitalin klinik dhe në Qendrën ndër-komunale për punë sociale janë paraqitur, parashtrësia në 2016, 2017 dhe 2018 për të cilat kanë dhënë përgjigje përkatëse. Për asnjë institucion nuk ka pasur ndërhyrje tek Avokati i popullit dhe asnjëri nuk është dënuar në pajtim me ligjin përkatës.

Në kuadër të kërkesës së paraqitur për qasje të lirë në të dhëna me karakter publik, institucioneve iu kërkua të paraqesin dokumente plotësuese shtesë. Nga këto pesë institucione, vetëm Qendra ndër-komunale për punë sociale, Shtip ka paraqitur Vendim për person zyrtarë për ndërmjetësim me informacione me karakter publik dhe Raport Vjetor për 2016, 2017 dhe 2018.

Raport nga monitorimi i transparencës dhe llogaridhënies në Rajonin planor Jug-Perëndimor

Rajoni planor Jug-Perëndimor përbëhet nga 9 komuna: Vevçani, Dibër, Debarcë, Kërçovë, Makedonski Brod, Ohëi, Plasnicë, Strugë dhe Qendër Zhupë. Në pajtim me regjistrimin e fundit të realizuar të popullsisë dhe amvisërive në 2002, në Rajonin planor Jug-Perëndimor jetojnë 221,651 banorë.

Lënda e kësaj analize dhe këtij raporti ishin institucionet e mëposhtme: Komuna e Strugës, Gjykata themelore - Strugë, Gjimnazi "Dr. Ibrahim Temo" - Strugë, Spitali i përgjithshëm - Strugë dhe Institucioni Publik Qendra ndër-komunale për punë sociale - Strugë.

Veprim në pajtim me Ligjin për mbrojtje të denoncuesve

Tipar i përbashkët i të gjitha institucioneve të analizuar është mungesa e personit të autorizuar të përcaktuar për pranim të kallëzimevellëzimeve/denoncimeve. Përveç Gjykatës themelore në Strugë, e cila shprehet në mënyrë të qartë se personi udhëheqës, gjegjësisht Kryetari i gjykatës është përgjegjës për pranim të kallëzimeve, institucionet e tjera aspak nuk tregojnë personin i cili do të ishte përgjegjës për pranim të kallëzimeve/denoncimeve. Në pajtim me Ligjin për mbrojtje të denoncuesve, nëse nuk emërohet person i autorizuar, automatikisht konsiderohet se personi përgjegjës për këtë detyrë është personi udhëheqës në institucionin përkatës (drejtori, etj.).

Institucioni publik Qendra ndër-komunale për punë sociale - Strugë nuk ka dhënë informacion nëse ka përshkruar akte me të cilat rregullojnë procedurat e brendshme për pranim të kallëzimeve/dekoncimeve nga denoncuesit, ndarje dhe përpunim të të dhënave nga kallëzimet dhe marrjen e masave për të siguruar mbrojtje të të dhënave personale dhe të tjera që i referohen

denoncuesve dhe kallëzimeve të denoncuesve, ndërsa të gjitha institucionet e tjera të analizuar u përgjigjën se ata nuk kishin përshkruar akte të tilla.

Në lidhje me numrin e njoftimeve të pranuar për kallëzim/denoncim të brendshëm, në pajtim me Ligjin për mbrojtje të denoncuesve, të cilët i referohen 2016, 2017 dhe 2018, Gjykata themelore në Strugë dhe Gjumnazi "Dr. Ibrahim Temo" u përgjigjën se nuk kanë pranuar asnjë njoftim të vetëm në vitet e përmendura, ndërsa Komuna e Strugës, Spitali i përgjithshëm në Strugë dhe Institucioni publik Qendra ndër-komunale për punë sociale - Strugë nuk kanë paraqitur përgjigje.

Për asnjë nga institucionet nuk është bërë njoftim i jashtë i mbrojtur në pajtim me Ligjin për mbrojtje të denoncuesve në tre vitet e analizuar, dhe gjithashtu në asnjë institucion nuk është zbatuar procedurë për mbikëqyrje nga Ministria e drejtësisë, në pajtim me dispozitat e Ligjit. Raporte gjysmë-vjetore për kallëzimet/denoncimet e pranuar nga denoncuesit drejtuar Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit nuk dërgohen fare nga institucionet e analizuar. Në pajtim me Ligjin e përmendur, asnjë institucion nuk është gjobitur, dhe gjithashtu asnjëri nga institucionet nuk ka organizuar trajnime për punonjësit e tyre ose persona të tjerë, në mënyrë që t'i njohë ata me të drejtat e tyre nga Ligji për mbrojtje të denoncuesve, dhe në mënyrë që të mund të njoftojnë për parregullsi në pajtim me ligjin.

Veprim në pajtim me Ligjin për qasje të lirë në të dhëna me karakter publik

Të gjitha institucionet e analizuar kanë emëruar persona zyrtarë që të realizojnë të drejtën për qasje të lirë në të dhëna me karakter publik. Komuna e Strugës ka dy persona zyrtarë, Gjykata themelore në Strugë - një person zyrtarë, Gjumnazi "Dr. Ibrahim Temo" - tre persona zyrtarë, Spitali i përgjithshëm në Strugë - dy persona zyrtarë dhe Institucioni Publik Qendra ndër-komunale për punë sociale - Strugë dy persona zyrtarë. Personat zyrtarë në të gjitha institucionet kanë arsim të lartë, ndërsa Gjykata themelore në Strugë ka saktësuar se në atë pozitë personi duhet të ketë diplomuar në Fakultetin e drejtësisë dhe të ketë dhënë provimin e jurisprudencës. Asnjë nga institucionet nuk parasheh

kompensim shtesë jashtë pagës për këta persona zyrtarë. Në Komunën e Strugës, pozicioni i punës së zyrtarëve të emëruar dhe të autorizuar, në pajtim me aktet për sistematizim të vendeve të punës, janë bashkëpunëtor për turizëm dhe këshilltar në njësinë për tatime. Në Gjykatën Themelore në Strugë është administratori i gjykatës, ndërsa në Gjimnazin "Dr. Ibrahim Temo" ata janë sekretar, pedagog dhe psikolog. Në Spitalin e përgjithshëm në Strugë, një person është këshilltar i prokurimit publik dhe tjetri është infermierja kryesore e spitalit. Në atë pozicion pune, në Institucionin publik Qendra ndër-komunale për punë sociale - Strugë, njëri person është punëtor social i diplomuar - ofruar i shërbimit, ndërsa personi tjetër është jurist i diplomuar – zyrtar administrativ.

Në Gjimnazin "Dr Ibrahim Temo" dhe në Institucionin publik Qendra ndër-komunale për punë sociale - Strugë, personat zyrtarë nuk kanë ndjekur asnjë trajnim pas marrjes së autorizimit; në Gjykatën themelore në Strugë personi ka ndjekur një trajnim, të financuar nga Misioni i OSBE-së në Shkup; në Komunën e Strugës personi që është këshilltar për turizëm ka ndjekur 5 trajnime të financuara nga Komuna, ndërsa në Spitalin e përgjithshëm në Strugë, personi i cili është këshilltar i prokurimit publik ka ndjekur dy trajnime, të financuara nga palë të treta. Asnjë nga institucionet nuk ka përshkruar akte të brendshme për veprim dhe procedurë për përgjigje ndaj kërkesave për qasje të lirë në të dhëna me karakter publik.

Sa i përket numrit të kërkesave të pranuar për qasje të lirë në të dhëna me karakter publik, Komuna e Strugës gjatë vitit 2016 ka pranuar 48 kërkesa, në vitin 2017 - 25 kërkesa, dhe në 2018 - 28 kërkesa. Në vitin 2016, dy kërkesa i janë dërguar mbajtësit të informacionit në pajtim me Ligjin, në vitin 2017 një kërkesë është përcjellur, dhe në 2018 nuk është përcjellur asnjë kërkesë. Në mënyrë analoge, në afatin e përcaktuar me ligj, në vitin 2016, janë përgjigjur 46 kërkesa, në vitin 2017 - 24 kërkesa, dhe në 2018 - 28 kërkesa. Komuna e Strugës nuk ka paraqitur përgjigje në pyetjen nëse kërkuesi ka parashtruar ankesë drejtuar Komisionit për mbrojtje të së drejtës për qasje të lirë në informacione me karakter publik për arsye të ndryshme, si dhe kundër Vendimit konkret të institucionit në tre vitet e përmendura.

Gjykata themelore në Strugë ka pranuar 24 kërkesa në 2016, 20 kërkesa në 2017, dhe gjithashtu në 2018. Gjatë tre viteve, asnjë kërkesë nuk është përcjellur tek ndonjë mbajtës tjetër i informacionit në pajtim me Ligjin, dhe asnjë ankesë nuk është parashtruar pranë Komisionit për mbrojtje të së drejtës për qasje të lirë në të dhëna me karakter publik. Në afatin e përcaktuar me ligj, në të tre vitet e përmendura, është dhënë përgjigje ndaj të gjitha kërkesave të pranuar.

Gjatë vitit 2016, Gjimnazi "Dr. Ibrahim Temo" nga Struga ka pranuar 2 kërkesa, në 2017 2 kërkesa, dhe në 2018 asnjë. Gjatë tre viteve, asnjë kërkesë nuk është përcjellur tek ndonjë mbajtës tjetër i informacionit në pajtim me Ligjin, dhe asnjë ankesë nuk është parashtruar pranë Komisionit kompetent. Në afatin e përcaktuar me ligj, në tre vitet e përmendura, janë përgjigjur të gjitha kërkesat e pranuar.

Spitali i përgjithshëm në Strugë gjatë vitit 2016 ka pranuar 2 kërkesa, në vitin 2017 - 5 kërkesa, dhe në 2018 - 3 kërkesa. Gjatë tre viteve, asnjë kërkesë nuk është përcjellur tek ndonjë mbajtës tjetër i informacionit në pajtim me Ligjin, dhe asnjë ankesë nuk është parashtruar pranë Komisionit kompetent. Në afatin e përcaktuar me ligj, në tre vitet e përmendura, janë përgjigjur të gjitha kërkesat e pranuar.

Institucioni publik Qendra ndër-komunale për punë sociale - Strugë gjatë vitit 2016 dhe në 2017 nuk ka pranuar asnjë kërkesë të vetme, ndërsa në vitin 2018 ka pranuar 2 kërkesa. Gjatë tre viteve, asnjë kërkesë nuk është përcjellur tek ndonjë mbajtës tjetër i informacionit në pajtim me Ligjin, dhe asnjë ankesë nuk është parashtruar pranë Komisionit kompetent. Në afatin e përcaktuar me ligj, në tre vitet e përmendura, janë përgjigjur të gjitha kërkesat e pranuar.

Asnjë institucion nuk ka arkëtuar ndonjë kosto nga kërkuesit e informacioneve (Komuna e Strugës dhe Institucioni publik Qendra ndër-komunale për punë sociale - Strugë nuk ka paraqitur përgjigje), ndërsa të dhënat për kontakt të personit të autorizuar për realizim të të drejtës për qasje të lirë në të dhënat me karakter publik janë të shpallura publikisht në faqet e internetit të

Komunës së Strugës dhe Gjykatës themelore - Strugë, ndërsa në institucionet e tjera ato nuk janë të shpallura publikisht. Asnjë institucion nuk ka shqiptuar dënime disiplinore ndaj personave përgjegjës (Komuna e Strugës nuk ka paraqitur përgjigje), dhe gjithashtu asnjë institucion nuk është gjëbatur në pajtim me Ligjin për qasje të lirë në të dhëna me karakter publik (Komuna e Strugës nuk ka paraqitur përgjigje). Vetëm Gjykata themelore - Strugë dhe Gjimmnazi "Dr. Ibrahim Temo" nga Struga kanë siguruar hapësirë të veçantë për realizimin e të drejtës për qasje, ndërsa institucionet e tjera të analizuara nuk kanë.

Veprim në pajtim me Ligjin për veprim me parashtresa dhe propozime

Të gjitha institucionet e analizuara kanë persona të autorizuar për veprim me parashtresa dhe propozime (Institucioni publik Qendra ndër-komunale për punë sociale - Strugë nuk ka paraqitur asnjë përgjigje të vetme në lidhje me këtë Ligj prandaj do të përjashtohet nga analiza e mëtutjeshme). Komuna e Strugës ka dy persona të autorizuar, Gjykata themelore në Strugë - një person të autorizuar, Gjimmnazi "Dr. Ibrahim Temo" - tre persona të autorizuar, ndërsa Spitali i përgjithshëm në Strugë - një person të autorizuar. Në të katër institucionet, personat e autorizuar kanë mbaruar arsim të lartë, ndërsa në Gjykatën themelore - Strugë theksohet qartë se ai person është jurist i diplomuar që ka kryer provimin e jurisprudencës. Asnjë nga institucionet nuk parasheh kompensim shtesë jashtë pagës për personat e autorizuar.

Në Komunën e Strugës, pozicioni i punës së zyrtarëve të autorizuar, në pajtim me aktet për sistematizim të vendeve të punës, janë bashkëpunëtor për turizëm dhe bashkëpunëtor i ri për zejtarë. Në Gjykatën themelore në Strugë është Kryetari i gjykatës, ndërsa në Gjimmnazin "Dr. Ibrahim Temo" janë sekretar, pedagog dhe psikolog. Në Spitalin e përgjithshëm në Strugë, personi i autorizuar është jurist/sekretar i spitalit.

Asnjë nga personat e autorizuar në të katër institucionet nuk ka ndjekur trajnime përkatëse (Komuna e Strugës nuk ka paraqitur përgjigje). Gjithashtu, asnjë institucion nuk ka përshkruar akte të brendshme për veprim me parashtresa dhe propozime. Lidhur me parashtresat dhe propozimet e pranuar

për vitin 2016, 2017 dhe 2018, Komuna e Strugës dhe Gjimnazi "Dr. Ibrahim Temo" nuk kanë pranuar asnjë në tre vitet e përmendura, Gjykata themelore në Strugë në vitin 2016 nuk ka pranuar parashtresa dhe propozime, në vitin 2017 ka pranuar 1, dhe në 2018 - 4, ndërsa Spitali i përgjithshëm në Strugë në vitin 2016 ka pranuar 3 parashtresa dhe propozime, në vitin 2017 - 1, dhe në 2018 nuk ka pranuar asnjë. Këto dy institucione kanë dorëzuar përgjigje për të gjitha parashtresat e pranuar, dhe si pasojë, kërkuesi nuk është drejtuar tek Avokati i popullit në asnjë rast.

Lidhur me parashtresat dhe propozimet e paraqitura nga parashtrues anonim, Komuna e Strugës dhe Gjimnazi "Dr. Ibrahim Temo" nuk kanë paraqitur përgjigje nëse veprojnë me parashtresa të tilla, Gjykata themelore në Strugë nuk vepron me parashtresa dhe propozime anonime, ndërsa në Spitalin e përgjithshëm - Strugë fare nuk janë paraqitur parashtresa dhe propozime të tilla (nuk ka përgjigje se si do të vepronin në rast se do të merrnin).

Gjimnazi "Dr. Ibrahim Temo" nuk mban evidencë për parashtresa dhe propozime të pranuar, ndërsa Komuna e Strugës, Gjykata themelore - Strugë dhe Spitali i përgjithshëm - Strugë mbajnë. Në Gjykatën themelore - Strugë sistemi i evidencës është emëruar si Regjistër për parashtresa dhe ankesa (RPA). Asnjë nga katër institucionet nuk ka arkëtuar ndonjë kompensim në bazë të tarifave për veprim me propozime në tre vitet e përmendura, dhe gjithashtu asnjë prej këtyre institucioneve nuk është gjobitur në pajtim me Ligjin për veprim me parashtresa dhe propozime (vetëm Komuna e Strugës nuk ka dorëzuar informacion). Vetëm Komuna e Strugës ka publikuar të dhënat për personin e autorizuar, ndërsa tre institucionet e tjera nuk e kanë bërë këtë.

Përfundime

Sipas analizës së realizuar, të dhënat e grumbulluara empirike dhe rezultatet e përmbledhura, mund të konkludohet se institucionet e analizuara në territorin e Komunë së Strugës vetëm pjesërisht kanë kapacitete institucionale për implementimin e dispozitave përkatëse të Ligjit për mbrojtje të denoncuesve,

Ligjit për qasje të lirë në të dhëna me karakter publik. dhe Ligjit për veprim me parashtresa dhe propozime, të cilat i referohen transparencës dhe llogaridhënies.

Më evidente është mungesa e kapaciteteve institucionale për sa i përket zbatimit të dispozitave përkatëse të Ligjit për mbrojtje të denoncuesve, ku asnjë nga pesë institucionet që ishin objekt i kësaj analize nuk ka përcaktuar person të autorizuar për pranim dhe veprim me kallëzime/denoncime për korrupsion. Gjendja është dukshëm më e mirë në raport me zbatimin e Ligjit për qasje të lirë në të dhëna me karakter publik dhe Ligjit për veprim me parashtresa dhe propozime, ku pothuajse të gjitha institucionet kanë emëruar persona të veçantë zyrtarë të autorizuar, të ngarkuar me pranim dhe përpunim të kërkesave për qasje të lirë në të dhëna me karakter publik dhe veprim me parashtresa dhe propozime.

Gjendje identike është hasur në të gjitha institucionet në lidhje me disa parametra, gjegjësisht: mosekzistimi i akteve të përshkruara për rregullim të procedurave të brendshme në lidhje me tre ligjet; asnjë institucion nuk është gjobitur për veprim në pajtim me ligjet; përgjigje janë dorëzuar nga të gjitha institucionet për të gjitha kërkesat, parashtresat dhe propozimet e pranuar; asnjë institucion nuk ka arkëtuar ndonjë tarifë, kosto apo harxhime për parashtruesit, por nga ana tjetër, personave zyrtarë të autorizuar për këto lëndë nuk u është paguar ndonjë kompensim shtesë jashtë pagës së rregullt; asnjë masë disiplinore nuk është shqiptuar për personat përgjegjës (në institucionet që kanë dorëzuar informacion); të gjithë personat zyrtarë të autorizuar kanë arsim të lartë.

Ka një shumëllojshmëri të përgjigjeve në lidhje me trajnimet e ndjekura nga personat e autorizuar, shpalljeve publike të të dhënave të tyre në faqet e internetit, mbajtjes së evidencës së kërkesave, parashtresave dhe propozimeve të pranuar, si dhe ekzistimit të një hapësire të veçantë për qasje në to.

Në përgjithësi, nuk ka asnjë institucion që dallon me kapacitet institucional në raport me zbatimin e tre ligjeve të përmendura. Por, mund të veçohen Komuna e Strugës dhe Gjykata themelore - Strugë si institucione të mirëorganizuara në këtë drejtim, Gjimnazi "Dr. Ibrahim Temo" dhe Spitali i

përgjithshëm - Strugë si i organizuar në mënyrë të moderuar dhe Institucioni publik Qendra ndër-komunale për punë sociale - Strugë si institucion më dobësisht i organizuar. Konkretisht, në pjesën e transparencës, Komuna e Strugës është në epërsi, ndërsa në fushën e trajnimeve të realizuara, si dhe pjesëmarrjen në trajnime të personave zyrtarë Komuna e Strugës dhe Gjykata themelore - Strugë.

Raport nga monitorimi i transparencës dhe llogaridhënies në planor të Pollogut

Rajoni planor i Pollogut përbëhet nga 9 komuna: Bogovinë, Brvenicë, Vrapçishtë, Gostivar, Zhelinë, Jegunovcë, Mavrovë dhe Rostushë, Tearcë dhe Tetovë. Sipas të dhënave nga regjistrimi i fundit i realizuar i popullatës dhe amvisërive në 2002, në Rajonin planor të Pollogut jetojnë 304,125 banorë.

Në Rajonin planor të Pollogut, monitorimi ka përfshirë institucionet e mëposhtme:

- Komunën e Tetovës,
- Gjimnazin e dytë "7 Marsi" - Tetovë,
- Gjykatën themelore - Tetovë,
- Spitalin klinik - Tetovë, dhe
- Institucionin publik Qendren ndër-komunale për punë sociale - Tetovë.

Veprim në pajtim me Ligjin për mbrojtje të denoncuesve

Në kuadër të kërkesave për qasje të lirë në të dhëna me karakter publik, me ndihmën e të cilave u siguruan të dhëna për vlerësim të transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve, grupi i parë i pyetjeve iu referua vlerësimin të kapaciteteve për zbatim të Ligjit për mbrojtje të denoncuesve. Nga pesë institucionet e monitoruara, Komuna e Tetovës, nuk ka paraqitur përgjigje për kërkesën e parashtruar.

Në pajtim me analizën e realizuar të të dhënave të paraqitura, mund të vërehen gjendjet e mëposhtme sa i përket zbatimit të Ligjit për mbrojtje të denoncuesve:

- Vetëm Spitali klinik - Tetovë ka emëruar person për pranim dhe veprim me kallëzime/denoncimet e denoncuesve, ndërsa tre subjektet e tjera nuk kanë emëruar person të tillë. Duhet të theksohet se në Gjimnazin e dytë "7 Marsi" -

Tetovë detyrimet për pranim dhe veprim me kallëzimet/denoncimet e denoncuesve i kryen personi udhëheqës.

- Lidhur me gjendjen me aktet e brendshme, mund të konstatohet gjithashtu se vetëm Spitali klinik - Tetovë ka akte të brendshme që rregullojnë procedurat e brendshme.

- Sipas informacioneve të ofruara, mund të konstatohet se përvoja e punës së personave që veprojnë me kallëzime/denoncime të denoncuesve, aty ku janë të përcaktuar persona të tillë, është më shumë se pesë vjet.

Veçanërisht interesante janë të dhënat në lidhje me trajnimet që u sigurohen personave që veprojnë me kallëzime/denoncime të denoncuesve. Përkatësisht, nga të gjitha informacionet e paraqitura mund të vërehet se nuk është organizuar asnjë trajnim dhe se asnjë person nuk ka marrë pjesë në ndonjë trajnim të organizuar nga kushdo.

Në kuadër të monitorimit u vlerësuan edhe mjetet e punës që i posedojnë personat e autorizuar. Kështu, në ato subjekte që kanë paraqitur përgjigje, edhe pse jo në pjesën më të madhe, janë siguruar mjete për punë.

Për personat që veprojnë me kallëzime/denoncime nuk ka të paraparë kompensim të veçantë jashtë pagës, në asnjë subjekt që ka paraqitur përgjigje.

Me rëndësi të veçantë për monitorimin ishin pyetjet që duhej të siguronin të dhëna për veprimet thelbësore të subjekteve, gjegjësisht për numrin e kallëzimeve/denoncimeve nga denoncuesit, për mënyrën e veprimit me kallëzimeve dhe të ngjashme. Duke pasur parasysh faktin se nga përgjigjet e paraqitura për këto subjekte, u konstatua se asnjë nga këto subjekteve, nuk ka pranuar asnjë kallëzim/denoncim në periudhën nga 2016 deri në 2018, për fat të keq nuk mund të bëhet një vlerësim objektiv i kapaciteteve për veprim me kallëzime/denoncime të denoncuesve.

Duke pasur parasysh faktin se kallëzimitar ose denoncues më të mëdhenj potencialë në pajtim me Ligjin për mbrojtje të denoncuesve janë të punësuarit, njëra nga pyetjet ishte nëse ishin organizuar trajnime, me të cilët punonjësit do të njihen me mundësinë për t'u paraqitur si kallëzimitar/denoncues. Vetëm Spitali

klinik - Tetovë ka siguruar qasje në këtë lloj informacioni, por jo në formën e trajnimit, por si prezantim me gojë.

Veprim në pajtim me Ligjin për qasje të lirë në të dhëna me karakter publik

Pjesa e dytë e pyetësorit të monitorimit përfshin pyetje që lidhen me zbatimin e Ligjit për qasje të lirë në të dhëna me karakter publik. Komuna e Tetovës, siç u tha më parë, nuk ka paraqitur përgjigje në lidhje me informacionin e kërkuar. Nga informacionet e paraqitura nga subjektet e tjera, shihet se vetëm Institucioni publik Qendra ndër-komunale për punë sociale - Tetovë nuk ka emëruar person për veprim me kërkesa për qasje të lirë në të dhëna me karakter publik, ndërsa subjektet e tjera kanë emëruar person të tillë.

Në dy nga subjektet e analizuar, personat për veprim me kërkesat për të dhëna me karakter publik kanë përfunduar shkencat juridike, ndërsa në njërin subjekt kanë përfunduar sociologjinë (arsimin e lartë) dhe gjimnazin (informatikë).

Në asnjë prej subjekteve, për personat që veprojnë me kërkesa për qasje të lirë në të dhëna me karakter publik, nuk është paraparë kompensim shtesë jashtë pagës.

Sa i përket vlerësimit të kapaciteteve njerëzore dhe mundësive për ngritje dhe zhvillim profesional, personi përgjegjës për veprim në Gjykatën themelore - Tetovë ka ndjekur një trajnim, ndërsa personi në Spitalin klinik - Tetovë ka ndjekur tre trajnime. Të gjitha trajnimet janë financuar nga donatorë të jashtëm.

Gjykata themelore - Tetovë dhe Institucioni publik Qendra ndër-komunale për punë sociale - Tetovë kanë përkrahur akte të brendshme interne për veprim në situata të këtitlla, ndërsa subjektet e tjera nuk kanë akte të tilla.

Analiza e kërkesave të pranuar për qasje të lirë në të dhëna me karakter publik, tregoi se bëhet fjalë për një numër shumë modest të kërkesave të pranuar, nëse marrim parasysh se bëhet fjalë për një periudhë prej tre vjetësh, kështu që Gjykata themelore Tetovë ka pranuar gjithsej 28 kërkesa, Spitali klinik -

Tetovë ka pranuar gjithsej 9 kërkesa, ndërsa Gjimnazi i dytë "7 Marsi" - Tetovë dhe Institucioni publik Qendra ndër-komunale për punë sociale - Tetovë nuk kanë marrë asnjë kërkesë.

Gjykata themelore Tetovë dhe Spitali klinik - Tetovë paraqitën përgjigje se të gjitha kërkesave iu përgjigjën brenda afatit, dhe se nuk është paraqitur asnjë ankesë lidhur me përgjigjet e kërkesave. Gjithashtu, këto dy subjekte kanë deklaruar se nuk kanë arkëtuar kompensim për përgjigjet e paraqitura të kërkesave.

Interesant është fakti që subjektet që kanë pranuar kërkesa për qasje të lirë në të dhëna me karakter publik, janë përgjigjur pozitivisht edhe në pyetjen "A janë shpallur publikisht të dhënat e kontaktit të personit/personave të autorizuar për realizim të të drejtës për qasje të lirë në informacione me karakter publik të institucionit tuaj, në faqen tuaj të internetit?", ndërsa subjektet që nuk kanë pranuar kërkesë të tillë u përgjigjën negativisht.

Veprim në pajtim me Ligjin për veprim me parashtresa dhe propozime

Në segmentin e tretë të monitorimit janë përfshirë çështje që kanë të bëjnë me vlerësimin e kapaciteteve sipas Ligjit për veprim me parashtresa dhe propozime. Në pjesën për Komunën e Tetovës, ajo që u theksua më parë aplikohet edhe këtu, gjegjësisht, Komuna e Tetovës nuk ka paraqitur përgjigje ndaj kërkesës.

Dy nga subjektet, Gjykata themelore Tetovë dhe Spitali klinik - Tetovë, kanë deklaruar se kanë persona përgjegjës për veprim në bazë të Ligjit për veprim me parashtresa dhe propozime, edhe atë në Gjykatën themelore Tetovë është kryetari i gjykatës, ndërsa në Spitalin klinik Tetovë është, jurist nga shërbimi juridik. Këto dy subjekte gjithashtu dorëzuan informacione sipas të cilave nuk është paraparë kompensim jashtë pagës për angazhim të personave të autorizuar për veprim me parashtresa dhe propozime. Dy subjektet e tjera deklaruan se nuk kishin përcaktuar person që vepron me parashtresa dhe propozime.

Sa i përket vlerësimit të potencialit njerëzor dhe avansimit profesional, u konstatua se asnjë prej këtyre personave nuk ka ndjekur trajnime në periudhën nga 2016 deri në 2018.

Vetëm Gjykata themelore e Tetovës u përgjigj se kishte përgatitur akte të brendshme interne për veprim sipas këtij ligji.

Nga të gjitha subjektet e analizuar, vetëm Gjykata themelore Tetovë ka pranuar parashtresa dhe propozime në periudhën e përmendur, gjithsej 54 parashtresa dhe propozime. Nga përgjigjja e përmendur shihet se është dorëzuar përgjigje për të gjitha parashtresat dhe propozimet. Gjithashtu, nga të dhënat e paraqitura, shihet se nuk është pranuar asnjë parashtresë anonime.

Sipas përgjigjeve të paraqitura, mund të konstatohet se asnjë nga subjektet e analizuar nuk ka vendosur në faqen e internetit të dhëna kontakti për personin që vepron me parashtresa dhe propozime.

Përfundime

Nga informacionet e dorëzuara të analizuar, e të cilat janë të rëndësishme për vlerësimin e mundësive dhe kapaciteteve për të mundur transparencë dhe llogaridhënie, mund të konkludohet si në vijim:

- Në periudhën e analizës, gjegjësisht periudhën nga 2016 deri në 2018, u pa se nuk është pranuar asnjë njoftim në asnjë subjekt, bazuar në Ligjin për mbrojtje të denoncuesve. Kjo tregon se duhet akoma të punohet për promovim të mëtjeshëm të këtij ligji dhe mekanizmave të tij;
- Pothuajse asnjë nga subjektet e analizuar nuk i publikon në faqen e tij të internetit të dhënat e kontaktit të personave që janë të angazhuar të vepron sipas ligjeve të përcaktuara;
- Dy nga subjektet e analizuar kanë potencuar se nuk kanë pranuar asnjë kërkesë për qasje të lirë në informacione me karakter publik në periudhën nga 2016 deri në 2018. Kjo tregon se ky instrument për sigurim të publicitetit dhe transparencës nuk është përdorur fare;

- Në periudhën nga 2016 deri në 2018, tre subjekte nuk kanë pranuar asnjë kërkesë bazuar në Ligjin për veprim me parashtrësia dhe propozime. Situata faktike tregon se një instrument tjetër që siguron publicitet dhe transparencë nuk është përdorur fare;
- Mungojnë trajnime për personat që veprojnë sipas ligjeve të përmendura. Përkatësisht, asnjë përmirësim dhe specializim profesional nuk është mundësuar për këta persona.

Përfundime dhe rekomandime

Nga monitorimi i zbatuar, mund të nxirren konkluzione të përbashkëta si më poshtë:

- Në parim, plotësohen kërkesat minimale të përcaktuara me dispozitat ligjore në lidhje me transparencën e institucioneve. Institucionet nuk tregojnë iniciativë për zbatim më të gjerë të dispozitave ligjore.
 - o 9 nga 25 institucionet u përgjigjën se kanë emëruar person të veçantë për pranim të kallëzimeve/denoncimeve nga denoncuesit (Tabela 1, Shtojca 1);
 - o 22 nga 25 institucionet janë përgjigjur se kanë përcaktuar person të veçantë për veprim me kërkesat për qasje të lirë në të dhëna me karakter publik (Tabela 5, Shtojca 1);
 - o 20 nga 25 instanca janë përgjigjur se kanë caktuar person të veçantë për veprim me parshtrësia dhe propozime (Tabela 8, Shtojca 1).
- Sipas përgjigjeve të institucioneve, mund të vërehet se personat e përcaktuar për veprim me kërkesa, në pajtim me ligjet e analizuara, kanë arsim të duhur dhe përvojë të mëparshme të punës, por pothuajse asnjë nga institucionet nuk investon fonde për trajnim të punonjësve të tyre. Kështu që,
 - o Vetëm 2 nga 25 institucionet janë përgjigjur se personi i veçantë i përcaktuar për pranim të kallëzimeve/denoncimeve nga denoncuesit ka ndjekur trajnime (Tabela 2, Shtojca 1);
 - o 14 nga 25 institucionet janë përgjigjur se personat e përcaktuar për veprim me kërkesa për qasje të lirë në të dhëna me karakter publik nuk kanë ndjekur trajnime përkatëse (Tabela 6, Shtojca 1);

- 25 institucione janë përgjegjgur se asnjëherë, asnjë person që vepron me parashtrësia dhe propozime të qytetarëve ka ndjekur ndonjë trajnim (Tabela 9, Shtojca 1).
- Nga të dhënat e paraqitura, mund të vërehet se ka mungesë transparence në lidhje me disponueshmërinë e të dhënave të kontaktit të personave të autorizuar, kështu:
 - Vetëm 3 nga 25 institucionet janë përgjegjgur se kanë publikuar të dhëna të kontaktit të personave të autorizuar në pajtim me Ligjin për mbrojtje të denoncuesve në faqen e tyre të internetit (Tabela 11, Shtojca 1);
 - 15 nga 25 institucionet janë përgjegjgur se kanë publikuar të dhëna për kontakt me personat e autorizuar në pajtim me Ligjin për qasje të lirë në të dhëna me karakter publik në faqen e tyre të internetit (Tabela 12, Shtojca 1);
 - Vetëm 5 nga 25 institucionet janë përgjegjgur se kanë publikuar të dhëna për kontakt me personat e autorizuar, në pajtim me Ligjin për veprim me parashtrësia dhe propozime në faqen e tyre të internetit (Tabela 13, Shtojca 1).
- Lidhur me kushtet minimale materiale dhe mjetet e punës të personave të autorizuar, duhet të theksohet se vetëm akti nënligjor i veçantë që buron nga Ligji për mbrojtje të denoncuesve parashih fonde minimale për punë, por në këtë tregues, 20 institucione janë përgjegjgur se nuk kanë siguruar të gjitha mjetet e nevojshme për punë në tërësi (Tabela 3 Shtojca 1).
- Nga ajo që u tha më lartë nuk habit as fakti që mungon një numër serioz i kërkesave bazuar në ligjet e përmendura. Kështu që,
 - 12 institucione nuk kanë pranuar asnjë parashtrësë dhe propozim të vetëm në pajtim me Ligjin për veprim me parashtrësia dhe propozime në periudhën 2016 deri në 2018 (Tabela 10, Shtojca 1);

- 5 institucione nuk kanë pranuar asnjë kërkesë për qasje të lirë në të dhëna me karakter publik në periudhën 2016 deri në 2018 (Tabela 7, Shtojca 1);
- Asnjë nga 25 institucionet e analizuar nuk ka pranuar asnjë kallëzim/denoncim nga denoncuesi në 2016, 2017 dhe 2018 veç e veç (Tabela 4, Shtojca 1).

Bazuar në atë që u përmend më sipër, dalin më shumë rekomandime.

Është e nevojshme:

- Emërimi i personave të autorizuar për veprim në pajtim me tre ligjet, aty ku ajo nuk është bërë;
- Përmirësimi i kapaciteteve njerëzore duke organizuar trajnime përkatëse për personat e autorizuar brenda subjektit dhe/ose financim të pjesëmarrjes në trajnime të organizuara nga palë të treta (organizata të shoqërisë civile, qendra arsimore);
- Miratim të akteve të domosdoshme të brendshme të parashikuara me dispozitat ligjore;
- Dorëzim me kohë të raporteve përkatëse pranë institucioneve shtetërore;
- Sigurim të fondeve për punë të personave të autorizuar për veprim në pajtim me ligjet përkatëse;
- Parashikim të një shume të caktuar në bazë të kompensimit për personat e autorizuar që veprojnë konform ligjeve përkatëse;
- Publikim të të dhënave të kontaktit të personave të autorizuar në faqen e internetit të institucionit, me qëllim të rritjes së numrit të kërkesave në lidhje me ligjet përkatëse;
- Organizim të takimeve me organizata lokale të shoqërisë civile dhe media lokale për të krijuar marrëdhënie dhe partneritet midis personave të autorizuar dhe organizatave lokale të shoqërisë civile dhe mediave;

- Vendorsje të një sistemi përgjegjësie për veprim të personave të autorizuar konform tre ligjeve, në rast të veprimit në kundërshtim me dispozitat ligjore.

Shtojca 1: Pasqyrë e treguesve kryesorë

Tabela 1

Detyrimet nga LMD për pranim dhe veprim ndaj kallëzimeve/denoncimeve për korrupsion, në institucionin tuaj i kryen personi udhëheqës apo ka përcaktuar person të autorizuar për pranim të njoftimeve?	Tetovë	Shkup	Manastir	Strugë	Shtip	Gjithsej
Po	2	2	2	1	2	9
Jo*	3	3	3	4	3	16

Tabela 2

Institucione në të cilat personi i autorizuar për pranim të kallëzimeve nga denoncuesit ka ndjekur trajnime	Tetovë	Shkup	Manastir	Strugë	Shtip	Gjithsej
Po, ka ndjekur trajnime	1	0	1	0	0	2
Jo, nuk ka ndjekur trajnime*	4	5	4	5	5	23

Tabela 3

Institucione në të cilat janë siguruar mjetet minimale për punë të personit i cili vepron në bazë të kallëzimeve/denoncimeve nga denoncuesit	Tetovë	Shkup	Manastir	Strugë	Shtip	Gjithsej
Po	2	1	0	0	2	5
Jo*	3	4	5	5	3	20

Tabela 4

Institucione të cilat kanë pranuar kallëzime/denoncime nga denoncuesi në 2016, 2017 dhe 2018 veç e veç	Tetovë	Shkup	Manastir	Strugë	Shtip	Gjithsej
Kanë pranuar kallëzime	0	0	0	0	0	0
Nuk kanë pranuar kallëzime/denoncime*	5	5	5	5	5	25

Tabela 5

Institucione të cilat kanë përcaktuar persona zyrtarë për realizim të DQL	Tetovë	Shkup	Manastir	Strugë	Shtip	Gjithsej
Ka përcaktuar person	3	5	4	5	5	22
Nuk ka përcaktuar person*	2	0	1	0	0	3

Tabela 6

Institucione në të cilat personat zyrtarë për realizim të DQL kanë ndjekur trajnime në periudhën 2016-2018.	Tetovë	Shkup	Manastir	Strugë	Shtip	Gjithsej
Më shumë se tre trajnime	1	1	1	2	1	6
Më pak se tre trajnime	1	1	1	1	1	5
Nuk ka ndjekur asnjë trajnim*	3	3	3	2	3	14

Tabela 7

Institucione të cilat kanë pranuar KQL në periudhën 2016-2018.	Tetovë	Shkup	Manastir	Strugë	Shtip	Gjithsej
Ka pranuar KQL	2	4	4	5	5	20
Nuk ka pranuar KQL*	3	1	1	0	0	5

Tabela 8

Institucione të cilat kanë përcaktuar person/a janë të autorizuar për veprim me parashtrësia dhe propozime?	Tetovë	Shkup	Manastir	Strugë	Shtip	Gjithsej
Ka përcaktuar person/persona	2	5	5	4	4	20
Nuk ka përcaktuar person/persona*	3	0	0	1	1	5

Tabela 9

Institucione në të cilat personi/at e autorizuar të përcaktuar për veprim me parashtresa dhe propozime, kanë ndjekur trajnime në periudhën 2016 - 2018	Tetovë	Shkup	Manastir	Strugë	Shtip	Gjithsej
Më shumë se tre trajnime	0	0	0	0	0	0
Më pak se tre trajnime	0	0	0	0	0	0
Nuk ka ndjekur asnjë trajnim*	5	5	5	5	5	25

Tabela 10

Institucione që kanë pranuar parashtresa dhe propozime në pajtim me LPP në periudhën 2016-2018.	Tetovë	Shkup	Manastir	Strugë	Shtip	Gjithsej
Ka pranuar	1	3	4	2	3	13
Nuk ka pranuar*	4	2	1	3	2	12

Tabela 11

Institucionet që kanë publikuar të dhëna për kontakt me persona të autorizuar, në pajtim me LMD në faqet e tyre të internetit	Tetovë	Shkup	Manastir	Strugë	Shtip	Gjithsej
Ka publikuar të dhëna për kontakt	0	0	2	0	1	3
Nuk ka publikuar të dhëna*	5	5	3	5	4	22

Tabela 12

Institucionet që kanë publikuar të dhëna për kontakt me persona të autorizuar, në pajtim me LQL në faqet e tyre të internetit	Tetovë	Shkup	Manastir	Strugë	Shtip	Gjithsej
Ka publikuar të dhëna për kontakt	2	4	4	2	3	15
Nuk ka publikuar të dhëna*	3	1	1	3	2	10

Tabela 13

Institucionet që kanë publikuar të dhëna për kontakt me persona të autorizuar, në pajtim me LPP në faqet e tyre të internetit	Tetovë	Shkup	Manastir	Strugë	Shtip	Gjithsej
Ka publikuar të dhëna për kontakt	0	2	2	1	0	5
Nuk ka publikuar të dhëna*	5	3	3	4	5	20

*duke përfshirë edhe nuk ka dorëzuar përgjigje.

*Nga gjithsej 25 institucione, një institucion nuk ka dorëzuar përgjigje.

* LMD – Ligji për mbrojtje të denoncuesve

* LPP – Ligji për veprim me parashtresa dhe propozime

* LQL – Ligji për qasje të lirë në të dhëna me karakter publik

* DQL – e drejta për qasje të lirë në të dhëna me karakter publik

* KQL – kërkesë për qasje të lirë në të dhëna me karakter publik